


# Treguesit demografikë

## Tremujori I, 2018

**Tiranë, më 14 Maj 2018:** Numri i lindjeve në tremujorin e parë 2018 rezulton 5.669, duke shënuar një rënie prej 18,0 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Numri i vdekjeve në tremujorin e parë 2018 rezulton 5.954, duke shënuar një rënie prej 12,3 %, krahasuar me tremujorin e parë 2017.

Gjatë tremujorit të parë 2018, numri i vdekjeve tejkaloi me 285 numrin e lindjeve.


Fig. 1 Shtesa natyrore e popullsisë



Në tremujorin e parë 2018, shtesa natyrore e popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë, shënon vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 443 numrin e vdekjeve.

Në tremujorin e parë 2018, shtesa natyrore regjistron vlerë negative në shtatë qarqe. Vlera më e ulët shënohet në qarkun e Korçës, ku numri i vdekjeve tejkalon me 211 numrin e lindjeve.

Fig. 2 Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T1 – 2018



### Lindjet

Numri më i ulët i lindjeve, në tremujorin e parë 2018, regjistrohet në qarkun e Gjirokastrës, 96 lindje, me një rënie prej 34,2 %, në krahasim me tremujorin e parë 2017. Numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës me 1.872 lindje, të cilat shënojnë rënie me 11,3 %, në krahasim me tremujorin e parë 2017.

Të gjitha qarqet pësuan rënie të numrit të lindjeve në tremujorin e parë 2018, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Rënie më të madhe të numrit të lindjeve gjatë kësaj periudhe e shënon qarku i Gjirokastrës me 34,2 % dhe qarku i Vlorës me 29,8 %.

**Tab. 1 Lindjet sipas qarqeve**

Qarqet	I-17	II - 17	III - 17	IV-17	I - 18
<b>Shqipëria</b>	<b>6.916</b>	<b>7.483</b>	<b>8.539</b>	<b>7.931</b>	<b>5.669</b>
1 Berat	311	334	346	328	228
2 Dibër	351	472	449	443	257
3 Durrës	716	763	934	857	605
4 Elbasan	701	676	879	740	575
5 Fier	707	730	797	781	534
6 Gjirokastër	146	112	150	158	96
7 Korçë	439	503	515	499	338
8 Kukës	251	279	306	255	186
9 Lezhë	329	368	398	406	285
10 Shkodër	438	504	618	483	400
11 Tiranë	2.111	2.379	2.661	2.529	1.872
12 Vlorë	389	333	441	423	273
*Të panjohur	27	30	45	29	20

\* Kategoria '**Të panjohur**' nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja, mungon.

### Vdekjet

Numri më i lartë i vdekjeve, në tremujorin e parë 2018, regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.429 vdekje, me një rënie prej 7,6 %, në krahasim me tremujorin e parë 2017. Numri më i ulët i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 136 vdekje, me një rënie prej 35,8 %, në krahasim me tremujorin e parë 2017.

Të gjitha qarqet pësuan rënie të numrit të vdekjeve në tremujorin e parë 2018, krahasuar me tremujorin e parë 2017. Rënien më të madhe të numrit të vdekjeve gjatë kësaj periudhe e shënon qarku i Kukësit me 35,8 % dhe qarku i Lezhës me 26,9 %.

**Tab. 2 Vdekjet sipas qarqeve**

Qarqet	I-17	II - 17	III - 17	IV-17	I - 18
<b>Shqipëria</b>	<b>6.791</b>	<b>4.930</b>	<b>5.103</b>	<b>5.408</b>	<b>5.954</b>
1 Berat	414	261	272	276	327
2 Dibër	297	208	229	186	248
3 Durrës	601	438	434	482	551
4 Elbasan	676	518	463	549	622
5 Fier	711	559	627	603	691
6 Gjirokastrë	245	206	171	199	213
7 Korçë	669	499	501	528	549
8 Kukës	212	131	125	142	136
9 Lezhë	331	222	221	244	242
10 Shkodër	597	378	446	454	485
11 Tiranë	1.546	1.125	1.240	1.338	1.429
12 Vlorë	485	381	363	404	455
*Të panjohur	7	4	11	3	6

\* Kategoria '**Të panjohur**' nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja nuk është i njohur.

# Shënime metodologjike

## 1. Lindjet

### *Të dhënat e lindjeve*

Të dhënat e lindjeve sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## 2. Vdekjet

### *Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve) edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë në vitin e mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

### **Përkufizime:**

**Shtesa natyrore e popullsisë:** Shpreh rritjen / rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohë. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

**Lindje e gjallë:** Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

**Vdekje:** Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile